



## Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/ Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, tehnologije i inovacije/ Ministry of Education, and Science*

*Kabineti i Ministrorit /Kabinet Ministra / Cabinet of the Minister*

---

### STATUTI I PËRKOSSHËM

#### I

### KOLEGJIT PUBLIK NDËRKOMBËTAR TË BIZNESIT NË MITROVICË (IBC-M)

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Neni 1 Themelimi

1. Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit (IBCM) (në tekstin e mëtejshëm: “IBC-M”) me seli në Mitrovicë, është themeluar në bazë të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 08-V-578 të datës 10.07.2023 për ratifikimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Nr. 21/136, të datës 22.03.2023 për themelimin e Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë si institucion i arsimit të lartë.

2. IBC-M është subjekt i pavarur juridik ndërsa nga aspekti i misionit paraqet vazhdimësi të International Business College Mitrovica (IBCM) i regjistruar më datë 16.03.2018 si fondacion vendor që ofron Arsim të Lartë në Kosovë në Ministrinë e Administratës Publike (Nr. i regjistrimit 5300419-5, dhe licencuar si Bartës Privat i Arsimit të Lartë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës. Të gjitha asetet e fondacionit IBCM do të barten si donacion në IBC-M. Asetet i referohen të gjitha asetëve duke përfshirë ndërtesat, mobilet, pajisjet, stafin, programet, studentët dhe të gjitha pajisjet e tjera softuerike dhe harduerike, mjetet dhe gjithçka tjetër që është pjesë e bilancit të fondacionit IBCM.

### Neni 2 Emri, selia, simbolet dhe struktura

1. Emri i Kolegjit është “Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë”, akronimi “IBC-M”.

2. Emri në përdorim i kolegjit është Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë.

3. Kolegji përdor akronimin “IBC-M”.

4. Kolegji shfrytëzon emrin Kolegji Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë IBC-M në çdo komunikim zyrtar, të brendshëm dhe ndërkombëtar, në aktet juridike që janë të autorizuara apo të nxjerra sipas këtij statuti, në simbolet dhe në dokumentet publike të tij.

5. Kolegji në gjuhën angleze përdor emrin ‘International Business College Mitrovica (IBC-M)’, që mund të përdoret edhe në formën e shkurtuar si ‘IBC-M’.

6. Emri i kolegjit në gjuhën serbe është ‘Međunarodni Poslovni Koledž u Mitrovici, ose shkurt, ‘IBC-M’.

7. Kolegji IBC-M është trashëgimtari i vetëm i misionit, programeve, pasurisë së luajtshme dhe paluajtshme të fondacionit IBCM i themeluar dhe regjistruar më 16.03.2018, në Ministrinë e Administratës Publike (Nr. i regjistrimit 5300419-5).

8. Selia qendrore e Kolegjit është në Mitrovicë, Rr. Bislim Bajgora pn, 40000 Mitrovicë.

9. Kolegji përfaqëson një monument të trashëgimisë arsimore dhe institucionale dhe si i tillë gëzon mbrojtje me këtë statut.

### **Neni 3 Simbolet**

1. Kolegji ka këto simbole:
  - 1.1. Stemën;
  - 1.2. Vulën dhe vulën e thatë;
  - 1.3. Flamurin;
  - 1.4. Pelerinën e rektorit, të prorektorëve dhe të dekanëve të njësive akademike.
2. Simbolet e kolegjit caktohen nga Këshilli Drejtues.
3. Njësitë akademike/departamentet e kolegjit janë të detyruara të përdorin emrin, stemën dhe flamurin e kolegjit.
4. Dita e përvjetorit të IBC-M-së është data 10 korrik, përkatësisht dita në të cilën është miratuar themelimi i kolegjit në Kuvendin e Kosovës.

### **Neni 4 Misioni**

1. Kolegji IBC-M do të:
  - 1.1. ndjekë rrugën e përsosjes në mësimdhënie dhe hulumtim;
  - 1.2. ofroj arsim ndërkombëtar të orientuar nga teoria në praktikë në të gjitha aktivitetet arsimore dhe kërkimore;
  - 1.3. jetë i hapur për të gjithë, në baza të paanësisë dhe meritës, pavarësisht përkatësisë etnike;
  - 1.4. mbështes zhvillimin ekonomik duke ofruar programe studimi që zhvillojnë aftësi profesionale të rëndësishme për tregun e punës;
  - 1.5. bashkëpunojë në mënyrë aktive me institucionet tjera të arsimit të lartë në Kosovë por edhe në rajon dhe Evropë; dhe si qëllim kryesor do të ketë:
    - 1.5.1. të kontribuojë për arsimin e lartë në gjuhën angleze;
    - 1.5.2. të promovojë mirëkuptimin ndëretnik;
    - 1.5.3. të zhvillojë programet e mësimdhënies në një perspektivë të gjerë evropiane dhe ndërkombëtare.

## **Neni 5**

### **Autonomia dhe liria akademike**

1. Kolegji gëzon autonomi institucionale. jashtë çdo lloji ndikimi politik ose ndikimi tjetër të jashtëm sa u takon aktiviteteve të tij.
2. Personeli dhe studentët e kolegjit gëzojnë:
  - 2.1. liri të partneritetit dhe shprehjes brenda strukturave të përmendura në këtë Statut dhe politikave të shpallura nga Kolegji;
  - 2.2. Të drejtën e mos-diskriminimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, mbi baza ekzistuese ose të supozuara si ato gjinore, racore, orientimi seksual, statusi martesor, ngjyre, gjuhe, religjioni, mendimi politik ose tjetër, origjine kombëtare, etnike ose shoqërore, shoqërimi me ndonjë komunitet kombëtar, statusi prone, lindjeje ose tjetër.

## **Neni 6**

### **Subjektiviteti juridik**

1. Kolegji ka statusin e personit juridik me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij, duke përfshirë:
  - 1.1. Të drejtën për të paditur;
  - 1.2. Rregullimin e organizimit të vet të brendshëm;
  - 1.3. Kufizimin e së drejtës për përdorimin e titullit të kolegjit vetëm për personat ose organizatat që e kanë autorizimin nga këshilli drejtues dhe me këtë statut;
  - 1.4. Zotërimin dhe menaxhimin e trojeve, godinave dhe pasurive të tjera kapitale;
  - 1.5. Pranimin dhe administrimin e fondeve nga çdo burim i ligjshëm;
  - 1.6. Propozimin e taksave, tarifave dhe gjobave ministrisë për miratim;
  - 1.7. Për të emëruar dhe ndërprerë marrëdhënien e punës së personelit akademik dhe joakademik si dhe për të ushtruar të gjitha detyrat e një punëdhënësi, siç është paraparë në legjislacionin në fuqi;
  - 1.8. Nënshkrimin e kontratave për mallra, shërbime dhe projekte kapitale;
  - 1.9. Miratimin për përmbajtjen dhe strukturën e programeve të tij akademike shkencore, artistike dhe profesionale;
  - 1.10. Krijimin e marrëdhënieve juridike me studentët dhe përshkrimin e kushteve për pranimin e tyre;
  - 1.11. Vendosijen e metodologjive të zbatuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
  - 1.12. Aplikimin e masave të duhura për vlerësim dhe sigurim të cilësisë;
  - 1.13. Dhënie dhe anulimin e titujve, diplomave, thirrjeve dhe gradave akademike dhe shkencore dhe titujve të nderit;

1.14. Të ndajë tituj nderi;

1.15. Themelimin në cilësinë e pronarit të ndërmarrjeve komerciale, jokomerciale dhe themelimin nën autoritetin dhe subjektivitetin kornizë të tij, të instituteve për qëllime mësimore, shkencore-hulumtuese, shërbimeve profesionale dhe artistike;

1.16. Nënshkrimin e marrëveshjeve me bartësit vendorë dhe ndërkombëtarë;

1.17. Miratimin, përmbajtjen dhe formën e flamurit, të vulës dhe të emblemave të tjera; dhe

1.18. Kompetenca të tjera të nevojshme për kryerjen e funksionit të tij sipas ligjit.

2. Kolegji mund të bëjë marrëveshje me Fondacionin e IBC-M sa i takon pranimit apo shfrytëzimit të kapitalit që është pronë e Fondacionit.

## **II. STRUKTURA ORGANIZATIVE**

### **Neni 7 Qeverisja e Kolegjit**

1. Organet udhëheqëse të kolegjit janë Këshilli Drejtues, Këshilli Akademik dhe Rektori. Këshilli Akademik është strukturë ekuivalente me Senatin (siç është e rregulluar në universitetet tjera publike në Kosovë.
2. Të gjitha organet qeverisëse të Kolegjit ushtrojnë aktivitetin e tyre mbi parimin e votimit me shumicë votash, nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë Statut.
3. Mandati i të gjithë zyrtarëve qeverisës dhe autoriteteve qeverisëse e anëtarëve të tij fillon më 1 tetor, nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë statut.

### **Këshilli Drejtues i Kolegjit**

#### **Neni 8 Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**

1. Këshilli drejtues i kolegjit (më tej “Këshilli Drejtues”) është autoriteti kryesor qeverisës i kolegjit.
2. Këshilli drejtues ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të kolegjit, si në vijim:
  - 2.1. Miraton planin strategjik të zhvillimit të kolegjit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
  - 2.2. Miraton planifikimin vjetor të buxhetit të kolegjit dhe mbikëqyr zbatimin e tij;
  - 2.3. Miraton raportin vjetor të punës së kolegjit, të përgatitur nga rektori, me kontribut të njëjësive akademike;

- 2.4. Zgjedh dhe liron nga detyra rektorin, bënë emërimin dhe lirimn nga detyra të strukturave të përkohshme drejtuese të kolegjit (ushtrues të detyrës së rektorit, prorektorëve dhe strukturave tjera të nevojshme për funksionalizimin e kolegjit).
- 2.5. Vendos për themelimin, ndarjen, shuarjen apo shkrirjen e njësive akademike;
- 2.6. Vendos për rregulloret e brendshme për menaxhim financiar në kolegji, duke përfshirë edhe nivelin e delegimit të kompetencave të menaxhimit financiar në nivel të njësive akademike për menaxhim të fondeve të marra nga qeveria dhe fondeve të gjeneruara nga jashtë;
- 2.7. Përfaqëson kolegjin në raport të komunikimit me ministrinë;
- 2.8. Zhvillon dhe miraton rregullat e punës së këshillit drejtues;
- 2.9. Merr vendim për çështjet e tjera që përcaktohen si kompetencë e këtij këshilli sipas ligjislacionit në fuqi;
- 2.10. Merr qëndrime dhe apo vendime lidhur me zhvillimet dhe aktivitetet në kolegji;
- 2.11. Këshilli Drejtues harton statutin e përkohshëm të kolegjit dhe rregulloreve bazë për funksionalizimin e Kolegjit.
- 2.12. Miraton rregulloret e propozuara nga rektori dhe apo këshilli akademik për funksionim të brendshëm të kolegjit, që nuk janë të natyrës akademike;
- 2.13. Miraton rregullore për modalitetet, kategorizimet dhe kompensimet e angazhimit të personelit akademik;
- 2.14. Zgjedh anëtarët e komitetit të auditimit;
- 2.15. Monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit nëpërmjet komitetit të auditimit të brendshëm.
- 2.16. Këshilli Drejtues mund të formojë komisione të përkohshme për ta këshilluar atë, lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.
- 2.17. Këshilli Drejtues monitoron implementimin e koncept-dokumentit të përpiluar nga Këshilli Themelues për funksionalizimin e kolegjit.

## **Neni 9**

### **Raporti vjetor i punës**

1. Këshilli drejtues do të publikojë raportin vjetor mbi plotësimin e punës së kolegjit, në përputhje me kërkesat e ministrisë dhe të Agjencisë Kosovare të Akreditimit. Raporti duhet të ofrojë informata lidhur me këto aspekte:

- 1.1. Objektivat e përgjithshme strategjike të arritura;
- 1.2. Të dhënat statistikore për tërë kolegjin dhe njësitë e tij akademike dhe organizative në lidhje me burimet, si:
  - 1.2.1. Buxheti (fondet publike dhe private);

- 1.2.2. Personeli (shifrat zhvillimore);
  - 1.2.3. Infrastruktura;
  - 1.2.4. Profillin akademik (ndryshimet në personelin akademik, fushat e studimit etj.);
  - 1.2.5. Programet e studimit;
  - 1.2.6. Numrin e studentëve (studentët e regjistruar për herë të parë, numri i përgjithshëm i studentëve, të diplomuarit);
  - 1.2.7. Kërkimet shkencore (projektet, publikimet, pjesëmarrja në konferenca, punimet);
  - 1.2.8. Bashkëpunimin ndërkombëtar;
  - 1.2.9. Raportin vjetor të auditorit për shfrytëzimin e duhur të mjeteve.
2. Në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë, këshilli drejtues i raporton ministrisë përgjegjëse, për realizimin e planit strategjik zhvillimor më së largu deri më 31 mars të vitit të ardhshëm.
  3. Raportet duhet të publikohen në ueb faqen e kolegjit.

#### **Neni 10** **Përbërja e anëtarëve të Këshillit Drejtues**

1. Këshilli drejtues përbëhet nga shtatë (7) anëtarë me të drejtë vote.
2. Ministria përgjegjëse për Arsim, Shkencë, Teknologji dhe Inovacion (MASHTI) emëron tre (3) anëtarë me të drejtë vote, sipas dispozitave të Ligjit për Arsimin e Lartë. Ata duhet të jenë persona me reputacion të lartë publik, me integritet të dëshmuar, me aftësi përkatëse profesionale, menaxheriale, si dhe me aftësi të tjera praktike, sidomos nga fushat e afarizmit dhe ndërmarrësisë. Asnjë nga anëtarët e emëruar nuk duhet të ketë lidhje të drejtpërdrejta aktuale me institucionin, në të cilin emërohet ose të jetë në marrëdhënie pune me një institucion tjetër të arsimit të lartë në Kosovë (publik dhe privat).
3. Këshilli akademik i kolegjit me shumicë absolute të gjithë anëtarëve zgjedh katër (4) anëtarë të këshillit drejtues me të drejtë vote, minimumi një (1) nga anëtarët e këshillit drejtues të emëruar nga kolegji vjen nga komuniteti akademik ndërkombëtar, ndërsa të tjerët vijnë nga radhët e personelit akademik të kolegjit.
4. Këshilli akademik merr parasysh kriterin e përfaqësimit të anëtarëve të këshillit drejtues nga komunitetet jo-shumicë dhe siguron përbërje shumë-etnike këshillit drejtues.
5. Këshilli akademik merr parasysh kriterin e përfaqësimit gjinor kur bën zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues nga radhët e personelit akademik të kolegjit.
6. Anëtarët e këshillit drejtues veprojnë të pavarur dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes tjetër individual apo grupor.
7. Anëtarë të këshillit drejtues nuk mund të zgjidhen:

- 7.1. Rektori, prorektori, dekani, prodekani/udhëheqësi i programit;
  - 7.2. Anëtarët e këshillit akademik;
  - 7.3. Sekretari i përgjithshëm;
  - 7.4. Personat që kanë ushtruar një aktivitet të lartë partiak apo politik në pesë (5) vjetët e fundit nga dita e shpalljes së konkursit.
8. Kandidimi dhe zgjedhja e anëtarëve të këshillit drejtues nga këshilli akademik rregullohet me rregulloren për zgjedhjet e përgjithshme të kolegjit.
  9. Rektori dhe sekretari i përgjithshëm janë anëtarë ex-officio të këshillit drejtues pa të drejtë vote.
  10. Me ftesë të këshillit drejtues në takime mund të marrin pjesë edhe prorektorët.
  11. Kryetari i parlamentit të studentëve mund të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit drejtues, pa të drejtë vote, kur trajtohen çështjet që kanë të bëjnë me studentët.

#### **Neni 11**

#### **Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues**

1. Mandati i anëtarëve të këshillit drejtues zgjat pesë (5) vjet me mundësi rizgjedhjeje edhe vetëm për një mandat.
2. Zgjedhjet për këshillin drejtues mbahen në qershor, kurse mandati i këshillit drejtues fillon më 1 tetor.
3. Mandati i anëtarëve të këshillit drejtues të emëruar nga kolegji mund të pushoj në rast të:
  - 3.1. Dorëheqjes;
  - 3.2. Lirimit nga detyra;
  - 3.3. Arsyeve shëndetësore;
  - 3.4. Dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale; 3.5. Plotësimin të moshës për pensionim;
  - 3.5. Vdekjes.
4. Procedurat për lirim nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues mund të iniciohen me shumicën absolute të votave nga:
  - 4.1. Këshilli drejtues;
  - 4.2. Këshilli akademik.



5. Vendimin për lirim nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues e merr këshilli akademik me shumicën e kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
6. Me rastin e liritimit nga detyra të anëtarit të këshillit drejtues, anëtari i posa zgjedhur do të zgjidhet për periudhën e mbetur të mandatit.
7. Anëtarët e këshillit drejtues, të emëruar nga MASHTI mund të shkarkohen nga Ministria me rekomandim të këshillit drejtues apo edhe pa të.

#### **Neni 12**

#### **Zgjedhja e kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit**

Këshilli drejtues zgjedh kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin prej anëtarëve të vet. të cilët nuk vijnë nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga këshilli akademik i kolegjit.

#### **Neni 13**

#### **Kuorumi dhe vendimmarrja**

1. Për mbajtjen e mbledhjeve të këshillit drejtues nevojitet kuorumi prej katër (4) anëtarëve me të drejtë vote.
2. Vendimet e këshillit drejtues merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Në rast se numri i votave është i barabartë, vota e kryesuesit është vendimtare.
3. Për vendimet e mëposhtme të këshillit drejtues nevojitet shumica e kualifikuar e dy të tretave (2/3) të votave të gjithë anëtarëve me të drejtë vote:
  - 3.1. Për lirimimin nga detyra të rektorit;
  - 3.2. Për miratimin e planit vjetor financiar;
  - 3.3. Për miratimin e rregullores se punës.
4. Mbledhjet e këshillit drejtues i thërret kryesuesi. Në raste të jashtëzakonshme mbledhjet thirren me kërkesën e dy të tretave (2/3) të anëtarëve të këshillit drejtues.
5. Rendi i ditës për takimet e këshillit drejtues vendoset nga kryesuesi, respektivisht zëvendëskryesuesi, në bashkëpunim me rektorin.

#### **Neni 14**

#### **Mbështetja e këshillit drejtues**

1. Zyra e rektorit ofron mbështetje të nevojshme teknike dhe infrastrukturore për këshillin drejtues.
2. Me kërkesë të këshillit, sekretari i përgjithshëm është përgjegjës për sigurimin e informatave plotësuese për vendimet e marra nga këshilli drejtues.
3. Këshilli drejtues do ta ketë edhe asistentin e vet i cili do jetë përgjegjës për ti ofruar përkrahjen juridiko-procedurale dhe teknike që i nevojitet Këshillit Drejtues.

## **Këshilli Akademik**

### **Neni 15 Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Këshilli akademik i kolegjit është organi më i lartë akademik i kolegjit.
2. Këshilli akademik është përgjegjës për:
  - 2.1. Çështjet e përgjithshme strategjike që lidhen me kërkime, studime, mësimdhënie dhe programet studimore në kolegji, duke përfshirë:
  - 2.2. Kriteret për pranimin e studentëve;
  - 2.3. Zgjedhjen dhe avancimin e personelit akademik;
  - 2.4. Politikat dhe procedurat për vlerësimin e studentëve dhe mbajtjen e provimeve për konstatimin e punës akademike të studentëve;
  - 2.5. Miratimin e programeve të studimit;
  - 2.6. Standardet akademike për zhvillim të programeve dhe zhvillim të sillabuseve;
  - 2.7. Standardet për sigurimin dhe zhvillimin e cilësisë së mësimit/studimit dhe funksionimit institucional;
  - 2.8. Procedurën për dhënien e kualifikimeve dhe të titujve akademikë të nderit;
  - 2.9. Procedurën për përjashtimin e studentëve për arsye akademike apo të tjera;
  - 2.10. Zhvillimin e politikës së mbrojtjes së pronësisë intelektuale të kolegjit dhe shfrytëzimin komercial të saj;
  - 2.11. Zhvillimin e rregullativës për vlerësim dhe menaxhim të performancës së personelit akademik.

### **Neni 16 Këshillat dhe komisionet e këshillit akademik**

1. Këshilli akademik mund të formojë këshilla ose komisione, për ta këshilluar atë lidhur me aspekte të veçanta të punës së tij.
2. Këshilli akademik themelon këto komisione dhe këshilla të përhershme:
  - 2.1. Komisioni i studimeve dhe cilësisë;
  - 2.2. Këshilli për botime;
  - 2.3. Këshilli i etikës;

3. Këshilli akademik formon komisionin për çështje statutare si komision këshillëdhënës. Komisioni shqyrton rastet e adresuara para tij nga autoritetet e kolegjit lidhur me zbatimin e duhur ose jo të statutit dhe përputhshmërinë e akteve dhe veprimeve të caktuara me statutin. Puna e komisionit rregullohet me rregullore të veçantë.

4. Këshilli akademik harton rregullore për përbërjen, rregullat e funksionimit dhe fushëveprimin e këtyre komisioneve dhe këshillave.

#### **Neni 17**

#### **Përbërja e Këshilli akademik/Senati**

1. Këshilli akademik përbëhet nga këta anëtarë me të drejtë vote:

1.1. Rektori;

1.2. Prorektorët;

1.3. Dekanët;

1.4. Nga një anëtar i zgjedhur nga stafi akademik i secilës njësi akademike (kështu numri i përgjithshëm i personave është i njëjtë me numrin e personave të renditur në pikën 1.3 të këtij neni);

1.5. Koordinatorin për sigurim të cilësisë i kolegjit;

1.6. Kryetari/kryetarja e këshillit përfaqësues të studentëve;

2. Sekretari i përgjithshëm i kolegjit është anëtar i përhershëm i këshilli akademik, pa të drejtë vote.

#### **Neni 18**

#### **Mandati i anëtarëve të Këshilli akademik**

1. Mandati i anëtarëve akademikë dhe joakademik të këshilli akademik është katër (4) vjet.

2. Mandati i anëtarëve nga radha e studentëve është një (1) vit.

3. Mandati i anëtarëve të këshilli akademik fillon në datën e njëjtë të fillimit të vitit akademik.

#### **Neni 19**

#### **Kryesimi i Këshilli akademik/Senatit**

Këshillin akademik e kryeson Kryesuesi i Këshillit Akademik i cili zgjidhet nga anëtarët e vet me shumicën absolute të gjithë anëtarëve me të drejtë vote, zgjedhja e kryesuesit të këshillit akademik rregullohet me rregulloren e Këshillit Akademik.

**Neni 20**  
**Rregullorja e punës**

1. Këshilli akademik nxjerr rregulloren e punës dhe rregulloren për procedurën e zgjedhjes kryesuesit dhe anëtarëve të tij.
2. Kryesuesi cakton procedurat për mbledhjet e këshilli akademik dhe të komisioneve të tij.

**Rektori**

**Neni 21**  
**Detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Rektori është autoriteti kryesor menaxhues dhe përfaqësuesi ligjor dhe institucional i kolegjit.
2. Rektori është përgjegjës për punën efektive dhe të rregullt të kolegjit dhe për menaxhimin e tij.
3. Në funksion të ushtrimit të autorizimeve të tij/saj, rektori ka përgjegjësitë si në vijim:
  - 3.1. Siguron zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të këshilli akademik dhe këshillit drejtues;
  - 3.2. Menaxhon procesin e hartimit të buxhetit dhe planit zhvillimor;
  - 3.3. Udhëheq realizimin e buxhetit vjetor dhe zbatimin e planit të punës;
  - 3.4. Realizon detyrat rreth procesit të rekrutimit dhe avancimit të personelit akademik;
  - 3.5. Zbaton detyrat në raport me bashkëpunimin me njësitë akademike për çështje të zbatimit të programeve studimore;
  - 3.6. Ushtron detyrat menaxheriale të kolegjit në raport me funksionimin, rolin dhe aktivitetin e kolegjit.
4. Rektori ka të drejtë të formojë komisione ose trupa këshillëdhënëse.

**Neni 22**  
**Procedura e zgjedhjes së rektorit**

1. Pozita e rektorit shpallet nga këshilli drejtues me konkurs publik në një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh kalendarike.
2. Konkurrimi për postin e rektorit është i hapur për kandidatët e brendshëm dhe të jashtëm.
3. Kritere minimale për të kandiduar për pozitën e rektorit janë që ai/ajo të ketë një integritet të lartë moral, të jetë figurë me kontribut serioz shkencor ose artistik, të ketë një sfond të publikimeve ndërkombëtare, që kërkohen për t'u emëruar së paku në thirrjen e një profesori të asociuar dhe të ketë përvojë dhe performancë të dëshmuar menaxhuese universitare.

4. Kandidati për rektor duhet të paraqesë një program qeverisës, kundrejt të cilit do të gjykohet merita e tij/saj për t'u zgjedhur në detyrën e tillë.
5. Konsiderohet e papajtueshme me pozitën e rektorit nëse kandidati ka ushtruar një funksion partiak apo politik në pesë (5) vjetët e fundit nga dita e shpalljes së konkursit.

### **Neni 23** **Vendimmarrja dhe votimi**

1. Komisioni profesional i zgjedhur nga këshilli akademik i propozon këshillit drejtues listën e kandidatëve të cilët i kanë plotësuar kushtet formale-juridike sipas konkursit.
2. Komisioni profesional ka për detyrë që të verifikojë nëse kandidatët e paraqitur për pozitën e rektorit i plotësojnë kushtet e parapara me konkurs.
3. Këshilli drejtues i interviston kandidatët, të cilët i kanë plotësuar kushtet për konkurrim në këtë post. Në këto intervista, secili kandidat prezanton një vizion gjithëpërfshirës për zhvillimin e strategjisë së ardhshme të kolegjit dhe për qasjen menaxhuese të tij/saj.
4. Këshilli drejtues ka të drejtë të refuzojë listën e kandidatëve të propozuar nga komisioni profesional, duke e arsyetuar atë dhe në atë rast rishpallet konkursi nga fillimi.
5. Rektori zgjidhet me shumicën absolute (shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote) në pajtim me dispozitat e këtij statuti.
6. Në rast se asnjëri kandidat nuk e fiton këtë shumicë në radhën e parë të votimit, atëherë dy (2) kandidatët me numrin më të madh të votave kualifikohen në votimin e dytë. Në rast se në votimin e parë ka kandidat që kanë numrin e njëjtë të votave për të shkuar në raundin e dytë, atëherë, kandidatët që kanë numër të njëjtë të votave hyjnë në një votim për tu kualifikuar për raundin e dytë. Nëse asnjëri nga dy (2) kandidatët nuk fiton shumicën absolute tri (3) herë radhazi (në të tri raundet), procedura e zgjedhjes përsëritet nga fillimi, siç është paraparë në këtë statut.
7. Emërimi i rektorit bëhet për një periudhë prej katër (4) vjetësh, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

### **Neni 24** **Simboli**

Autoriteti i rektorit simbolizohet përmes gjerdanit të rektorit.

### **Neni 25** **Mandati i rektorit**

1. Mandati i rektorit fillon më 1 tetor.
2. Mandati i rektorit mund të përfundojë para kohe në rast të:
  - 2.1. Dorëheqjes;

- 2.2. Lirimit nga detyra;
  - 2.3. Arsyeve shëndetësore;
  - 2.4. Dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - 2.5. Plotësimit të moshës për pensionim;
  - 2.6. Vdekjes.
3. Procedurat për lirim nga detyra të rektorit mund të iniciohen me shumicën absolute të votave nga:
- 3.1. Këshilli drejtues;
  - 3.2. Këshilli akademik.
4. Vendimi i këshillit drejtues për lirim nga detyra është i vlefshëm me shumicën e kualifikuar prej dy të tretave (2/3) të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
5. Me rastin e lirim nga detyra të rektorit, përfundon edhe mandati i prorektorëve.
6. Në rast të lirim nga detyra, rektori dhe prorektorët e porsazgjedhur do të zgjidhen për periudhën e mbetur të mandatit të rektorit të liruar nga detyra.

#### **Neni 26**

#### **Zgjedhja e ushtruesit të detyrës së rektorit**

1. Në rastin e lirim nga detyra të rektorit, apo në çfarëdo rasti të mbetjes vakante të pozitës së rektorit, këshilli drejtues zgjedh ushtruesin e detyrës së rektorit deri në përfundimin e procedurës së zgjedhjes së rektorit për periudhën e mbetur të mandatit.
2. Ushtruesi i detyrës së rektorit do të mbajë postin e rektorit deri në fund të mandatit, në qoftë se deri në shpalljen e zgjedhjeve në kolegji kanë mbetur jo më shumë se gjashtë (6) muaj.
3. Ushtruesi i detyrës së rektorit zgjidhet personi që i plotëson kriteret minimale për kandidim, siç përcaktohet me këtë statut.

#### **Neni 27**

#### **Ankimimi**

1. Rektori ka të drejtë të parashtojë ankesë në ministri kundër lirim nga detyra.
2. Vendimi i ministrisë është vendim përfundimtar në procedurë administrative.
3. Kundër vendimit të ministrisë mund të iniciohet procedurë në gjykatën kompetente.

## **Prorektorët**

### **Neni 28 Numri i prorektorëve**

Kolegji ka më së shumti tre (3) prorektorë.

### **Neni 29 Detyrat e prorektorëve**

1. Detyrat e prorektorëve caktohen nga rektori në pajtim me dispozitat e këtij statuti.
2. Rektori ka të drejtë t'u delegojë përgjegjësi të plota ligjore për një kohë të caktuar.
3. Përgjegjësi të ndara ose të përbashkëta mund t'u caktohen prorektorëve në fushat si në:
  - 3.1. Mësimdhënie, çështje akademike dhe të studentëve, dhe cilësi;
  - 3.2. Buxhet, financa, infrastrukturë dhe administratë;
  - 3.3. Bashkëpunim ndërkombëtar, projekte, inovacion dhe kërkim shkencor.

### **Neni 30 Ushtrimi i përkohshëm i detyrës së rektorit**

Rektori e emëron njërin nga prorektorët për të ushtruar përkohësisht detyrën e rektorit në rast të pamundësisë apo paaftësisë së përkohshme.

### **Neni 31 Emërimi i prorektorëve**

1. Rektori propozon listën e emrave për prorektorë nga radha e profesorëve dhe ligjëruesve të kolegjit, pasi ta ketë njoftuar këshillin akademik. Prorektorët zgjedhën me votim të fshehtë nga Këshilli Drejtues me shumicën absolute të votave, në një radhë votimi. Nëse kandidati i propozuar nuk zgjidhet atëherë rektori ka të drejtë të propozojë kandidatin e ri.
2. Mandati i prorektorëve është i lidhur me atë të rektorit, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.

### **Neni 32 Mandati i prorektorëve**

1. Mandati i prorektorëve mund të përfundojë para kohe në rast të:
  - 1.1. Dorëheqjes;
  - 1.2. Lirimit nga detyra;
  - 1.3. Arsyeve shëndetësore;

- 1.4. Dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - 1.5. Plotësimi të moshës për pensionim;
  - 1.6. Vdekjes.
2. Procedura për lirimin nga detyra të prorektorit mund të iniciohet nga:
    - 2.3. Këshilli drejtues;
    - 2.4. Këshilli akademik.
  3. Vendimin për lirimin nga detyra të prorektorit e bënë Këshilli Drejtues me shumicën absolute të votave të anëtarëve.
  4. Në rast të shkarkimit të prorektorit, rektori propozon kandidatin e ri për prorektor, i cili zgjidhet nga Këshilli Drejtues për periudhën e mbetur të mandatit.

### **Neni 33**

#### **Sekretari i përgjithshëm i kolegjit**

1. Sekretari i përgjithshëm është zyrtari më i lartë ekzekutiv dhe administrativ i kolegjit, me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta të përcaktuara në kontratën e tij, e cila nënshkruhet nga kryesuesi i këshillit drejtues.
2. Sekretari i kolegjit është udhëheqës i administratës së kolegjit.
3. Sekretari i përgjigjet rektorit për administrim efikas, ekonomik dhe efektiv në të gjitha nivelet e kolegjit. Në këtë pozitë sekretari i përgjithshëm përgjigjet për të gjitha çështjet që nuk janë kompetencë e organeve ose e udhëheqësve të tjerë.

### **Neni 34**

#### **Zgjedhja e sekretarit të përgjithshëm**

1. Sekretari i përgjithshëm i kolegjit zgjidhet nga këshilli drejtues sipas propozimit të komisionit profesional të emëruar nga rektori në bazë të rregullave të ligjit përkatës në fuqi dhe konkursit publik.
2. Mandati i sekretarit të përgjithshëm është pesë (5) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për vetëm një mandat.

### **Neni 35**

#### **Kriteret për pozitën e sekretarit të përgjithshëm**

1. Kandidatët që konkurrojnë për pozitën e sekretarit të përgjithshëm të kolegjit duhet të përmbushin këto kushte:
  - 1.1. Të kenë diplomë universitare master ose ekuivalente me së paku katër (4) vjet të studimeve në drejtësi, ekonomi ose fusha relevante për udhëheqjen dhe menaxhimin e administratës së një institucioni arsimor / universitar ose kolegji;



- 1.2. Të kenë së paku pesë (5) vjet përvojë pune në pozitë menaxheriale;
- 1.3. Të kenë aftësi dhe rezultate të dëshmuara profesionale, organizative dhe menaxhuese;
- 1.4. Të kenë njohuri të mjaftueshme për proceset e arsimit, artit dhe kërkimeve;
- 1.5. Të kenë njohuri të mjaftueshme për proceset dhe procedurat relevante ligjore dhe buxhetore të lidhura me arsimin e lartë;
- 1.6. Të përfaqësojnë një figurë me integritet të lartë personal, me një të kaluar jo partiake dhe jopolitike;
- 1.7. Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.

### **Neni 36**

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë e sekretarit të përgjithshëm**

1. Sekretari i përgjithshëm i kolegjit ka këto detyra dhe përgjegjësi:
  - 1.1. Është zyrtari më i lartë i administratës;
  - 1.2. Është zyrtar përgjegjës për udhëheqje efikase, ekonomike dhe efektive të kolegjit;
  - 1.3. Është shef i drejtorëve të departamenteve në kuadër të Administratës Qendrore të Kolegjit;
  - 1.4. Është zyrtar përgjegjës për përgatitjen teknike të procesit buxhetor; 1.5. Është redaktor përgjegjës i buletinit të kolegjit;
  - 1.5. Është përgjegjës për dhënien e të drejtës për qasje në një bazë specifike të të dhënave;
  - 1.6. Është përgjegjës për çështje të tjera që kërkohen nga këshilli drejtues dhe rektori, të cilat nuk janë të përcaktuara me këtë statut.

### **Neni 37**

#### **Njësitë përbërëse të kolegjit**

1. Kolegji përbëhet prej:
  - 1.1. Fakulteteve;
  - 1.2. Njësive tjera akademike dhe qendrave edukative/arsimore dhe të inovacionit, dhe
  - 1.3. Institutit kërkimor.

### **Neni 38**

#### **Parakushtet për statusin e fakultetit**

1. Parakushtet për të fituar statusin e një fakulteti janë:

1.1. veprimtaria në një apo në më shumë fusha të veçanta të arsimit akademik, në kërkime shkencore apo në krijimtari artistike, në kuadër të kornizës institucionale të Kolegjit;

1.2. infrastruktura e mjaftueshme;

1.3. numri i duhur i personelit akademik që mundëson plotësimin e kërkesave akademike për një periudhë afatgjatë.

#### **Neni 39**

#### **Humbja e statusit të fakultetit**

1. Fakulteti humb statusin nëse:

1.1. I nënshtrohet integrimit apo shpërbërjes.

#### **Neni 40**

#### **Organizimi i brendshëm i fakulteteve**

1. Pavarësisht prej madhësisë (numrit të përgjithshëm të personelit akademik, numrit të mjaftueshëm të profesorëve të rregullt sipas nevojës së fushave të ndryshme akademike dhe përqindjes së personelit të përhershëm), fakulteti duhet t'i plotësojë standardet ndërkombëtare (përmasat kritike) në mënyrë që të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm dhe veprimtari profesionale në të gjitha fushat shkencore për një periudhë afatgjatë.

2. Fakulteti e përqendron profilin e vet arsimor dhe kërkimor për nevojat e vendit, në riaftësimin dhe për mësimin gjatë gjithë jetës të profesionistëve, si dhe ofron shërbime praktike për partnerët vendorë.

#### **Neni 41**

#### **Llojet e studimeve**

1. Fakulteti ofron këto lloje të studimeve:

1.1. studime profesionale (aplikative);

1.2. studimet themelore – bachelor;

1.3. studimet master:

1.3.1. master (Msc dhe MA), dhe

1.3.2. master profesional (studentët që kryejnë masterin profesional nuk mund të regjistrohen në studimet e doktoratës shkencore).

1.4. Studimet e doktoratës.

#### **Neni 42**

#### **Fakultetet**

1. Në përbërjen e vet kolegji i ka këto fakultete:

- 1.1. Fakulteti i Mjedisit, Teknologjisë dhe TI-së;
  - 1.2. Fakulteti i Menaxhimit Ndërkombëtar të Biznesit;
  - 1.3. Fakulteti i Shkencave Sociale;
2. Me vendim të Këshillit Drejtues të propozuar nga Këshilli akademik mund të themelohen edhe fakultete të tjera.

#### **Neni 43** **Dekani- zgjedhja e dekanit**

1. Çdo fakultet udhëhiqet nga dekan.
2. Dekanët zgjedhën nga Këshilli Akademik për një periudhë katërvjeçare (4), nga radha e profesorëve të fakultetit përkatës, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat.
3. Kandidatët për postin e dekanit duhet të jenë individë me kualifikime relevante akademike dhe të kenë aftësi dhe përvojë në udhëheqje, si dhe të kenë së paku thirrjen akademike “Profesor asistent”. Në rastet kur drejtimet janë profesionale dekanit mund të jete edhe me titullin Ligjërues.
4. Rektori propozon listën e emrave për dekan nga radha e profesorëve të kolegjit tek këshilli akademik. Dekanët zgjedhën nga Këshilli Akademik me shumicën absolute të votave të përgjithshme, në një radhë votimi. Nëse kandidati/kandidatët e propozuar nuk zgjidhet atëherë rektori ka të drejtë të propozojë kandidatin e ri.
5. Fakultetet që kanë më shumë se një program studimi, caktohet edhe nga një udhëheqës për secilin program dhe këta e mbështesin punën e dekanit. Udhëheqësi i programit propozohet nga Dekani dhe zgjedhën nga Këshilli Akademik me shumicën absolute të votave të përgjithshme, në një radhë votimi, mandati i udhëheqësit të programit është i lidhur me mandatin e dekanit.
6. Udhëheqësi i programit është ekuivalent me prodekanin siç njihet në universitetet tjera publike.
7. Mandati i rregullt i dekanit fillon me 1 tetor.

#### **Neni 44** **Detyrat e dekanit**

1. Dekani për punën e tij/saj i përgjigjet rektorit. Detyrat e dekanit janë:
  - 1.1. Të sigurojë menaxhim efektiv për proceset administrative dhe menaxheriale në fakultet;
  - 1.2. Të sigurojë udhëheqje akademike në fushat përkatëse për zhvillimin e mësimin, punës shkencore në fakultet;
  - 1.3. Të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme në zbatimin e vendimeve të përcaktuara nga këshilli akademik;

- 1.4. Udhëheq procesin e planifikimit strategjik dhe vjetor në nivel fakulteti dhe hartimin e raportit vjetor të punës së fakultetit;
  - 1.5. Udhëheq procesin e planifikimit vjetor të realizimit të programeve studimore, duke përfshirë vëllimin e angazhimit të personelit akademik në mësimdhënie, aktivitete shkencore dhe aktivitete shërbyese në institucion dhe komunitet;
  - 1.6. Menaxhon sistemin e monitorimit dhe vlerësimit të performancës së personelit akademik sipas sistemit të miratuar nga këshilli akademik;
  - 1.7. Udhëheq procesin e vlerësimeve të brendshme, menaxhmentin e departamenteve dhe strukturat tjera përkatëse, sipas sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë të miratuar në nivel kolegji;
2. Dekani mund të përfaqësojë kolegjin edhe për çështjet ligjore në emër të fakultetit vetëm me autorizim të rektorit.

#### Neni 45 Mandati i dekanit

1. Mandati i dekanit mund të përfundojë para kohe në rast të:
  - 1.1. Dorëheqjes;
  - 1.2. Lirimit nga detyra;
  - 1.3. Arsyeve shëndetësore;
  - 1.4. Dënimit me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
  - 1.5. Plotësimit të moshës për pensionim;
  - 1.6. Vdekjes.
2. Procedura për lirimin nga detyra të dekanit mund të iniciohet nga:
  - 2.1. Këshilli drejtues;
  - 2.2. Këshilli akademik;
  - 2.3. Rektori;
3. Shkarkimin e dekanit mund ta bëjë këshilli akademik me shumicën absolute të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve (50%+1).
4. Ne rast të përfundimit të mandatit, dekani i porsazgjedhur do të emërohet për periudhën e mbetur të mandatit.

**Neni 46**  
**Komisioni i Studimeve dhe cilësisë i Kolegjit**

Komisioni i studimeve dhe cilësisë themelohet si organ këshillëdhënës për kolegjin.

**Neni 47**  
**Detyrat e komisionit të studimeve dhe cilësisë të kolegjit**

1. Komisioni i studimeve është përgjegjës për:
  - 1.1. Shqyrtimin e propozimeve të programeve të reja të studimeve;
  - 1.2. Përshtatjen dhe ndryshimin e programeve ekzistuese të studimit;
  - 1.3. Kërkesat për ndërrimin e programeve të studimeve nga studentët;
  - 1.4. Zhvillimi i koncepteve, vlerësimi dhe komentimi i çështjeve të natyrës.
2. akademike, në mënyrë që të përgatisë raporte, për të cilat vendoset në këshillin e njësisë përkatëse.
  - 2.1. Komisioni i studimeve kryen detyrat e caktuara në kuadër të sistemit të vlerësimeve dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke përfshirë:
    - 2.1.1. Miratimin e planit për vlerësimet e proceseve akademike dhe administrative;
    - 2.1.2. Shqyrtimin e raporteve nga proceset e vlerësimeve të brendshme;
    - 2.1.3. Zhvillimin e rekomandimeve për dekanatin në bazë të gjetjeve të vlerësimeve;
    - 2.1.4. Detyra të tjera të saktësuara në këtë statut dhe në rregulloret përkatëse.

**Neni 48**  
**Përbërja e komisionit të studimeve dhe cilësisë**

1. Anëtarët e komisionit të studimeve janë:
  - 1.1. Dekanët dhe udhëheqësit e programeve;
  - 1.2. Nga një profesor nga secili drejtim i studimeve;
  - 1.3. Dy (2) studentë me notë mesatare së paku nëntë (9) (sipas sistemit të notimit të IBC-M);
2. Anëtarët e personelit akademik zgjidhen nga këshilli akademik.
3. Anëtari student zgjidhet nga këshilli i studentëve.

## Instituti Neni 49

1. Instituti është pjesë e Kolegjit me mision në kërkim dhe inovacion. Instituti përkufizohet si një njësi e vetme ose shumëdisiplinore e organizuar për të kryer aktivitete arsimore, kërkimore dhe/ose shërbime. Instituti IBC-M karakterizohet me qëndrueshmëri organizative dhe një buxhet operativ vjetor të përcaktuar nga kolegji dhe me të hyrat vetanake të institutit.
2. Instituti është entitet jofitimprurës i regjistruar në departamentin për organizatat joqeveritare në kuadër të ministrisë së punëve të brendshme të Kosovës.
3. Organizimi i brendshëm i institutit përcaktohet me statut, me aktin e themelimit dhe në pajtim me ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare<sup>1</sup>.
4. Instituti udhëhiqet nga Bordi Drejtues dhe Drejtori i Institutit :
5. Organet drejtuese përcaktohen me statutin e Institutit dhe në pajtim me ligjin për ligjin për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.
6. Zgjedhja e Bordit Drejtues dhe Drejtorit të Institutit është e rregulluar me statut të Institutit.
7. Instituti i raporton Rektorit dhe Prorektorit për Kërkime shkencore ose të emëruarit të tyre.
8. Instituti mund të ketë një ose më shumë qendra të lidhura me të.
9. Instituti duhet të ketë staf aktiv të përfshirë nga fakultet dhe aktivitete që kanë një lidhje logjike me aktivitetet kërkimore të kolegjit.
10. Nëse instituti humb burimin(et) e financimit dhe nuk është në gjendje të marr fonde të reja burimi(et) do të ndërpritet funksionimi. Njoftimi për ndërprerjen i jepet nga këshilli drejtues me tre muaj paralajmërim.
11. Instituti i kolegjit IBC-M shërben si një qendër e integruar e Kërkimit dhe Inovacionit.
12. Instituti konsiderohet si një shtëpi (hub) e projekteve që kapërcejnë kufijtë tradicionalë akademikë, duke i lejuar hulumtuesit dhe studiuesit të marrin përsipër aktivitetet kryesore kërkimore dhe shërbimet tjera trajnuese të kolegjit.
13. Instituti IBC-M ofron hapësirë për ekipet e hulumtuesve të fakultetit, si dhe studentët e tyre dhe të diplomuarve që fitojnë përvojë praktike.
14. Kolegji shqyrton aplikimet për hapësirë pune në institut dhe ndihmon në përcaktimin e vendndodhjes dhe gjatësisë së projekteve. Projektet afatshkurtra mund të përdorin hapësirën vetëm për disa muaj, ndërsa projektet e tjera mund të kalojnë vite duke krijuar dhe zgjeruar punën e tyre.
15. Instituti përmban laboratorë fleksibël, zyra dhe hapësira bashkëpunimi që mund të personalizohen për t'iu përshtatur nevojave të kolegjit dhe studenteve. Ndërtesa përfshin gjithashtu objekte kërkimore thelbësore të disponueshme për studiuesit në të gjithë kampusin, si dhe partneritet të jashtëm; një laborator vizualizimi më të avancuar; auditorë të brendshme dhe të jashtme; dhe hapësirë për evente dhe trajnime.

---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare

## **Programet dhe mënyrat e studimit**

### **Neni 50 Statusi i studentit**

1. Personi i regjistruar në Kolegjin IBC-M e ka statusin e studentit.
2. Statusi i studentit vërtetohet me kartën identifikuese të studentit ose me dokument tjetër zyrtar të lëshuar nga kolegji.

### **Neni 51 Mënyrat e studimit**

1. Kolegji ofron dy mënyra të studimit:
  - 1.1. Studime të rregullta;
    - 1.1.1. Studime në format të kombinuar me prani fizike dhe online;
  2. Studime me korrespondencë, të cilat organizohen në pajtim me rregullat e veçanta të përcaktuara nga këshilli akademik.
3. Studenti mund të ketë statusin e:
  - 3.1. Studentit të rregullt;
  - 3.2. Studentit me korrespondencë;
  - 3.3. Studentit vizitor.

### **Neni 52 Gjuha e mësimdhënies**

Kolegji organizon mësimdhënien në gjuhën angleze me mundësi të kombinimit në gjuhë shqipe dhe gjuhë serbe nëse për këtë vendosë këshilli akademik/senati.

### **Neni 53 Përmbajtja e programeve të studimeve**

1. Programet e studimit përmbajnë:
  - 1.1. Titullin e studimit;
  - 1.2. Llojin e studimit;
  - 1.3. Thirrjen akademike (Titullin akademik);
  - 1.4. Kushtet për regjistrim;
  - 1.5. Objektivat dhe rezultatet;

- 1.6. Hollësitë mbi përmbajtjet programore;
  - 1.7. Vlera në pikë sipas ECTS (Lëndët, punimi i diplomës);
  - 1.8. Format dhe strategjitë e mësimdhënies;
  - 1.9. Metodatat e vlerësimit të studentëve;
  - 1.10. Literaturën bazë.
2. Përmbajtjet, strukturimi dhe procesi i hartimit të programeve dhe plan-programeve do të përcaktohen me rregullore të nxjerrë nga këshilli akademik.

#### **Neni 54**

##### **Kreditë për studimet themelore dhe studimet themelore të integruara**

1. Studimet themelore (baçelor) kanë 180 deri 240 pikë të ECTS-së, duke reflektuar ngarkesën 30 ECTS për një (1) semestër.
2. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve biçelor fitohet thirrja akademike “Baçelor i shkencës,” “Baçelor i arteve” dhe “Baçelor Profesional”.

#### **Neni 55**

##### **Punimi i diplomës**

1. Programet e studimeve biçelor mund të përfundojnë me punimin e diplomës për biçelor ose me provim para komisionit sipas definimit të bërë në programin e studimit.
2. Punimi i diplomës për biçelor punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushën e caktuar shkencore.
3. Punimi i diplomës për biçelor mund të elaborohet bashkë nga dy ose tre studentë (grup hulumtues) dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.
4. Kërkesa për elaborimin e punimit të diplomës për biçelor nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.
5. Procedura për aplikim, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për biçelor përcaktohet nga këshilli i njësisë akademike në bazë të dispozitave të caktuara në rregulloren për studimet biçelor që e miraton këshilli akademik.

#### **Neni 56**

##### **Kreditë për studimet master**

1. Studimet master kanë 60 deri 120 pikë të ECTS-së, duke reflektuar ngarkesën prej 30 ECTS për një semestër.
2. Përfundimi me sukses i studimeve themelore – biçelor është kusht për regjistrimin e studimeve master.



3. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve master fitohet thirrja akademike master shkencor (Master i shkencës apo Master i arteve) apo Profesional.

#### **Neni 57**

##### **Punimi i temës së studimeve master**

1. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e temës për master në pajtim me programin e studimit.
2. Punimi i temës master punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se studenti ka zhvilluar aftësi të hulumtimit dhe njohuritë dhe aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushën e caktuar shkencore për nivelin master.
3. Punimi i temës së masterit mund të elaborohet nga dy ose tre studentë (grupi kërkimor).
4. Aplikimi për elaborimin e punimit të diplomës për master nga dy ose tre studentë vendoset nga këshilli i njësisë akademike.
5. Procedura për paraqitje, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të temës së masterit përcaktohet nga këshilli i njësisë akademike sipas rregullores për studimet master të miratuar nga këshilli akademik.

#### **Neni 58**

##### **Studimet e doktoratës**

1. Kolegji rezervon të drejtën e organizimit të studimeve të doktoratës.
2. Studimet e doktoratës janë studimet me të larta akademike.
3. Studimet e rregullta të doktoratës organizohen në së paku gjashtë (6) semestra, kërkojnë 180 pikë të ECTS-së dhe përfundim me sukses të studimeve të mëparshme me më së paku 300 pikë të ECTS-së.
4. Kusht për fitimin e titullit doktor shkence është përfundimi me sukses i studimeve të doktoratës dhe mbrojtja me sukses e temës së doktoratës para komisionit të mbrojtjes.
5. Studimet e doktoratës janë të rregulluara me rregullorën për studimet e doktoratës të cilën e nxjerrë këshilli akademik.

#### **Neni 59**

##### **Parandalimi i plagjiaturës dhe niveleve të palejuara të ngjashmërisë**

Këshilli akademik nxjerr rregullore të veçanta me të cilën përcakton kushtet, procedurat dhe mënyrat e parandalimit të plagjiaturës dhe niveleve të palejuara të ngjashmërisë për temat e diplomës të studimeve themelore, master dhe të doktoratës.

#### **Neni 60**

##### **Programet e veçanta të studimeve**

1. Fakultetet kanë të drejtë të themelojnë programe të veçanta për studim: 1.1. Për programet dylëndore të studimeve:

- 1.1. Për programet ndërdisiplinore të studimeve;
- 1.2. Për programet e përbashkëta të studimeve.
- 1.3. Programet Top-up Bachelor.

**Neni 61**  
**Programet dylëndore të studimeve**

1. Programet dylëndore të studimeve ofrohen nga njësitë akademike në një program të përbashkët të studimeve dhe përmbajnë dy fusha të studimeve të po kësaj njësie.
2. Përgjegjësitë e secilit partner kontribuues përcaktohen në programin e studimeve.
3. Programin e studimeve e propozon dhe miraton këshilli akademike.
4. Me përfundimin e suksesshëm të studimeve fitohet diploma e përbashkët dhe studenti i diplomuar fiton thirrjen profesionale në të dy fushat e studimit.

**Neni 62**  
**Programet ndërdisiplinore të studimeve**

1. Programet ndërdisiplinore të studimeve përcaktohen nga këshilli akademik, ndërsa propozohen nga dy apo më shumë njësi akademike për të tri nivelet e studimit.
2. Përgjegjësitë e secilit partner përcaktohen në programin e studimit.
3. Këshilli Akademik (Këshilli akademik/senati) themelon komisionin për studime ndërdisiplinore, i cili është përgjegjës për:
  - 3.1. Zhvillimin e programit të studimeve;
  - 3.2. Çështjet organizative dhe teknike;
  - 3.3. Procedurat për realizim.
4. Këshilli Akademik (Këshilli akademik/senati) merr vendimin përfundimtar për të gjitha rregulloret e studimeve.

**Neni 63**  
**Programet e dyfishta dhe te përbashkëta të studimeve**

1. Programet e dyfishta dhe te përbashkëta të studimeve mund të zhvillohen në mes të Kolegjit IBC-M dhe të kolegjeve të tjera për të tri nivelet e studimit, në bazë të marrëveshjes për partneritet.
2. Programet e dyfishta dhe te përbashkëta të studimeve përcaktohen nga këshilli akademik dhe ofrohen nga njësitë akademike për të tri nivelet.

3. Obligimet e secilit institucion partner përcaktohen në programin e studimeve në bazë të marrëveshjes së përbashkët institucionale.

4. Këshilli akademik bën zgjedhjen e anëtarëve për komisionin e studimit të përbashkët ndërinstitucional apo emërtim ekuivalent sipas dakordimit të institucioneve partnere, i cili është përgjegjës për:

4.1. Zhvillimin e programit të studimeve;

4.2. Çështjet organizative dhe teknike;

4.3. Zbatim të procedurave dhe proceseve në funksion të zbatimit të programit sipas specifikave të detajuara në programin studimor dhe marrëveshjen e partneritetit.

#### **Neni 64**

#### **Programet Top-up Bachelor**

1. Programet Top-up Bachelor mund të zhvillohen nga Kolegji IBC-M dhe në partneritet me ndonjë institucion tjetër që ofron nivelin e pestë (5) sipas Kornizës Kombëtarë të Kualifikimeve në Kosovë (KKK) dhe që ka akreditim për ofrim të këtij niveli, ku studentët nga niveli i pestë mund të vazhdojnë studimet në nivelin Bachelor në semestrin e pestë.

2. Studenti pas përfundimit të studimeve (shtatë semestra) fiton titullin Bachelor profesional me 210 kredi ECTS.

#### **Neni 65**

#### **Kurset dhe programet e tjera**

1. Kolegji ka të drejtë të ofroj edhe kurse dhe programe të natyrës mikrokredenciale apo të tjera për publikun dhe profesionistët, siç janë programet e arsimimit dhe aftësimit profesional si dhe kurse tjera të aftësimit profesional të nivelit IV dhe V sipas KKK.

2. Modalitetet e zhvillimit dhe ofrimit të kurseve dhe programeve të tjera rregullohen me dispozitat e miratuara nga këshilli akademik dhe akreditohen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në Kosovë (AKK), ndërsa certifikatat nënshkruhen nga rektori ose dekani.

3. Këto kurse ofrohen si shërbim ndaj shoqërisë, ekonomisë dhe profesionistëve.

#### **Neni 66**

#### **Pranimi i kandidateve në studime**

1. Secili kandidat gëzon të drejtën për të konkurruar për studime në IBC-M, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Kushtet për pranim në studimet themelore – bachelor në IBC-M janë:

2.1. Përfundimi me sukses i shkollës së mesme në Kosovë, i vërtetuar me diplomë;

2.2. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku dymbëdhjetë (12) vjet të shkollimit, të vërtetuar me diplomë përkatëse;

2.3. Përfundimi me sukses i shkollës fillore dhe të mesme me së paku dymbëdhjetë (12) vjet të shkollimit, të vërtetuar me diplomë përkatëse, të fituar në botën e jashtme, në qoftë se është bërë barasvlerësimi me certifikatën e maturës;

2.4. Vendimi për njohjen e diplomës dhe barasvlerën merret nga Ministria përkatëse.

2.5. Njohjen e gjuhës angleze.

3. Këshilli akademik/senati nxjerr rregullore, të cilat përcaktojnë në hollësi kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore-bachelor.

#### **Neni 67**

##### **Pranimi ne studime master**

1. Studentët në studime Master pranohen mbi bazën e konkurrimit, sipas rezultateve të studimeve paraprake dhe ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë.

2. Studentet të cilët kanë përfunduar studimet paraprake lejohen të hyjnë në konkurrencë të barabartë për pranim në studime master apo doktoratë nga të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë.

3. Kriteret e posaçme për pranim në studimet master do të caktohen nga Këshilli akademik/senati në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

#### **Neni 68**

##### **Punimi i diplomës master**

1. Programet e studimeve master përfundojnë me punimin e tezës për master, në pajtim me programet e studimeve.

2. Punimi i diplomës master punohet individualisht nga studenti, duke vërtetuar se aftësitë e arritura gjatë kohës së studimit mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve komplekse kërkimore në fushat e caktuara shkencore.

3. Punimi i diplomës master mund të elaborohet nga dy (2) ose tre (3) studentë (grup kërkimor), dhe aty duhet të shënohet qartë kontributi i secilit kandidat.

4. Aplikimi për elaborim të punimit të diplomës për master nga dy ose tre studentë vendoset nga Komisioni Mësimor/Shkencor.

5. Procedura për paraqitje, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës, për master, përcaktohet me rregullore të studimeve përkatëse.

#### **Neni 69**

##### **Pranimi ne studime te doktoratës**

1. Studentët në studime të Doktoratës pranohen mbi bazën e konkurrimit, sipas rezultateve të studimeve paraprake dhe ekuivalencës së tyre, sikurse përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë.

2. Kriteret e posaçme për pranim në studime të doktoratës caktohen nga Këshilli akademik/senati, në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

#### **Neni 70**

##### **Numri i vendeve per studime bachelor, master dhe doktorate si dhe mënyra e financimit te tyre**

1. Numri i vendeve për studime bachelor, master dhe doktoratë përcaktohet nga Këshilli akademik/senati për çdo vit të parë të studimit në secilën njësi akademike, me propozimin e këshillit përkatës në harmoni me strategjinë e zhvillimit të Kolegjit. Vendimi bazohet në numrin e përgjithshëm të studentëve që do të shkollohen me shpenzime publike të ofruara nga ana e Ministrisë.

2. Studentëve me korrespondencë, të studimeve bachelor, master dhe të doktoratës, të cilët nuk financohen nga fondet publike, por që arrijnë rezultate të shkëlqyera në mësim, mund t'iu akordohet një vend studimi, i cili financohet nga fondet publike. Kjo mund të ofrohet nga viti i dytë i studimit, ose në vitin vijues të studimit. Kushtet dhe kriteret për të fituar këtë të drejtë i përcakton Bordi Drejtues me propozim të Këshilli akademik/senati.

#### **Neni 71**

##### **Organi per nxjerrjen e rregullave te konkursit dhe kriteret e regjistrimit**

Rregullat për shpalljen e konkursit dhe kriteret për regjistrim të studentëve të rinj nxirren nga Këshilli akademik/senati.

#### **Neni 72**

##### **Procedura e ankimimit**

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar në vitin e parë të studimeve bachelor dhe master, si dhe në studime të doktoratës mund të ankohen kundër vendimit brenda tri(3) ditëve të punës, pas shpalljes së rezultateve të zgjedhjes.

2. Vendimi përfundimtar rreth ankesës merret nga komisioni prej tre (3) anëtarësh, kryesuar nga prorektori për mësim dhe çështje të studentëve dhe i përbërë nga anëtarë të tjerë të emëruar nga Rektori.

#### **Neni 73**

##### **Përcaktimi i suksesit akademik**

1. Për përcaktimin e suksesit akademik do të aplikohen këto metoda:

- 1.1. provimi;
- 1.2. projekti semestral;
- 1.3. punimi seminarik;
- 1.4. punëtoritë;

- 1.5. praktika profesionale;
- 1.6. testi praktik gjatë ushtrimeve;
- 1.7. interpretimi dhe prezentimi i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera;
- 1.8. kritere të tjera të përcaktuara me syllabuse të lëndëve përkatëse.

**Neni 74**  
**Notat**

1. IBC-M do të zbatojë këto nota për të përshkruar nivelin e suksesit në provime:
  - 1.1. dymbëdhjetë (12) dhe dhjetë (10) (shkëlqyeshëm);
  - 1.2. shtatë (7) (shumë mirë);
    - 1.3. katër (4) (mirë);
    - 1.4. dy (2) (mjaftueshëm);
    - 1.5. zero dhe minus tre (0 dhe -3) (pamjaftueshëm).
2. Kandidati kalon provimin me sukses me notat nga dy deri dymbëdhjetë (2-12).

**Neni 75**  
**Viti akademik**

1. Kolegji organizon studimet në pajtim me programet ekzistuese të studimit gjatë vitit akademik, i cili zgjat dymbëdhjetë (12) muaj.
2. Viti akademik fillon më 1 tetor dhe mbaron më 30 shtator.
3. Periudha aktive e studimeve (ligjëratat, ushtrimet, vlerësimet) është e ndarë në dy semestra.
  - 3.1. Semestri dimëror, që fillon më 1 tetor dhe mbaron më 31 Janar.
  - 3.2. Semestri veror që fillon më 15 shkurt dhe mbaron më 15 qershor.
4. Lënda ligjërohet gjatë 15 javëve në semestër.

**Neni 76**  
**Humbja e statusit të studentit**

1. Studenti i rregullt humb statusin për këto arsye:
  - 1.1. Kur vendos të largohet nga studimet;

- 1.2. Kur i ka përfunduar studimet;
  - 1.3. Kur dështon të regjistrohet në vitin akademik;
  - 1.4. Kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve;
  - 1.5. Kur arrin numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet;
  - 1.6. Në rastin e përjashtimit, në bazë të vendimit të nxjerrë pas procedurës disiplinore.
2. Studenti mund të kërkojë një herë që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve për një apo dy vjet. Vendimin e merr këshilli akademik. Në rast se merret vendim pozitiv, studenti do ta ketë sërish statusin e studentit të rregullt.
  3. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në rastet e dëshmuara si të:
    - 3.1. Sëmundjes së rëndë;
    - 3.2. Kujdesi për fëmijët nën moshën tri (3) vjeçare;
    - 3.3. Shtatzënisë dhe lehonisë;
    - 3.4. Tjera të justifikuar.
  4. Vendimin përfundimtar e merr dekani i njësisë akademike.

#### Neni 77

#### **Mbajtja e statusit të studentit të rregullt**

1. Statusi i studentit të rregullt mbahet brenda dy vjetëve pasi të jenë përfunduar të gjitha provimet. Gjatë kësaj kohe studenti duhet të japë provimin e diplomës që t'i përfundojë me sukses studimet.
2. Studenti që e ka tejkaluar kohën e paraparë për të përfunduar me sukses diplomën mund të paraqesë kërkesë te dekani i njësisë akademike për zgjatjen e kësaj periudhe edhe për një vit.

#### Neni 78

#### **Regjistrimi i serishëm**

1. Studenti mund të regjistrohet sërish si student i rregullt pa ndonjë pengesë në lidhje me periudhën e pezullimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij statuti.
2. Periudha e pezullimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij statuti nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
3. Në qoftë se planprogrami valid në kohën e regjistrimit të parë të studentit nuk zhvillohet në vitin vijues të regjistrimit të studentit pas pezullimit të përkohshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të këtij statuti, komisioni i studimeve i njësisë akademike vendos për provimet diferenciale ose për obligimet tjera shtesë si kusht për vazhdimin e studimeve.

### **Neni 79** **Ndërrimi i programit të studimit**

1. Ndërrimi i programit të studimit është i mundur në mes programeve të studimit me qëllim të arritjes së nivelit të njëjtë të arsimit në pajtim me dispozitat e këtij statuti.
2. Studenti mund të ndërrojë programin duke kaluar në program të ri në vitin e dytë e tutje të studimeve në rast të ndërrimit të programit si për shembull ndryshimet në emërtim të programit pas procesit të akreditimit/riakreditimit.
3. Studenti mund të ndryshojë drejtimin e studimit duke kaluar në një program të afërt brenda ose jashtë njësisë akademike dhe procesi i lejimit të lëvizjes, kriteret, dhe ekuivalentimi i arritjeve në programin e vjetër vendosen nga njësia akademike por duke mos ra ndesh me dispozitat e statutit dhe aktet tjera të kolegjit.
4. Njësitë akademike nuk duhet të anashkalojnë kapacitetet në dispozicion për programin në të cilin regjistrohet studenti si dhe respektojnë kufizimet në kuotat për atë program të caktuar nga autoriteti i akreditimit. Ndërrimi i drejtimin të studimit nuk mund të bëhet nëse studenti nuk ka kryer obligimet e vitit të parë në programin e vjetër.

### **Neni 80** **Procedura për ndërrim të programit të studimit**

1. Studenti duhet t'ia dorëzojë kërkesën për ndërrimin e programit të studimit komisionit për studime të njësisë akademike, ku dëshiron të vazhdojë studimet. Bashkëngjitur me kërkesën duhet të jetë evidenca për plotësimin e suksesshëm të kërkesave bazuar në programin e mëparshëm të studimit.
2. Komisioni i studimeve përcakton detyrimet individuale për ndërrimin e programit të studimit në pajtim me rregullat e caktuara të programit të studimit.
3. Vendimi për ndërrimin e programit të studimit duhet të merret nga këshilli i njësisë akademike me propozimin e komisionit të studimeve.

### **Neni 81** **Ndërrimi i programit nga një institucion tjetër i arsimit të lartë**

Gjatë ndërrimit të programit të studimit prej një kolegji tjetër në Kolegji do të vlejné rregullat e njëjta si ato gjatë ndërrimit të programit të studimit brenda kolegjit.

### **Neni 82** **Mobiliteti i studentëve**

1. Në pajtim me programin e studimeve, studenti mund të zgjedhë dhe të regjistrojë lëndë të caktuara në njësitë tjera akademike të kolegjit në qoftë se lënda e zgjedhur nuk zhvillohet në fakultetin ku është i regjistruar studenti.
2. Regjistrimi i lëndës mund të bëhet me lejen e njësisë akademike ku është i regjistruar studenti dhe me pajtimin e njësisë akademike ku studenti e regjistron lëndën.



3. Me rastin e lejimit, studentit i jepet vërtetimi për lejimin për regjistrim të lëndës së caktuar dhe lartësia e ECTS kredive që do të fitohen me përfundimin e lëndës. ECTS kreditë e fituara do t'i llogariten në programin e studimeve të studentit.
4. Në dokumentin zyrtar të studentit shënohen të dhënat për lëndën e regjistruar, përmbushja e obligimeve të studentit dhe suksesi i treguar. Për ECTS kreditë e fituara, studentit i lëshohet dëshmi nga njësia akademike ku studenti i ka fituar ato.
5. Mobiliteti ndërkombëtar i studentëve dhe në mes të universiteteve dhe kolegjeve në Kosovë rregullohet me akt të veçantë të kolegjit. Me këtë akt dhe me marrëveshje me kolegjin prej nga vjen studenti mysafir do të rregullohen edhe të drejtat dhe obligimet e studentëve mysafir, pagesat për studime dhe çështje tjera lidhur me studentin mysafir.

### **Neni 83** **Vlerësimi i studentëve**

1. Këshilli akademik miraton rregullativën e përgjithshme për sistemin e vlerësimit të performancës së studentëve në kuadër të punës së tyre në realizimin e programit të studimit.
2. Programet e studimit dhe sillabuset e lëndëve reflektojnë parimet e vlerësimit të vazhdueshëm të punës së studentëve që duhet të ngërthejnë elemente të kombinuara të metodave në vijim:
  - 2.1. Testet e mesme;
  - 2.2. Testet finale apo provimet;
  - 2.3. Punime të shkruara;
  - 2.4. Prezantime;
  - 2.5. Demonstrim praktik;
  - 2.6. Interpretim dhe prezantim i krijimtarisë artistike dhe i punëve të tjera;
  - 2.7. Projekte studimore.

### **Neni 84** **Afatet e provimeve**

1. Provimet e semestrit dimëror për studime bachelor dhe master mbahen gjatë afatit të provimeve të vendosura nga njësia akademike në periudhën e dimrit (shkurt) dhe pranverës (prill).
2. Provimet e semestrit verorë për studime bachelor dhe master mbahen gjatë afatit të provimeve të vendosura nga njësia akademike në periudhën e verës (qershor dhe gusht).
3. Periudha e saktë për çdo afat është e përcaktuar me kalendarin e përgjithshëm të studimeve, i cili është i pranuar nga këshilli akademik dhe i hapur për publikun. Hollësitë rreth datës së fillimit dhe përfundimit të secilit afat të provimeve dhe rrjedhës e proceseve të tjera të ndërlidhura përcaktohen nga njësia akademike.

4. Oraret e provimeve do të përcaktohen në atë mënyrë që studenti të mos ketë më shumë se dy provime/teste në të njëjtën ditë.

**AKTIVITETI SHKENCOR**  
**Neni 85**  
**Zhvillimi i kërkimeve shkencore**

1. Kolegji bën kërkime shkencore dhe punë artistike me qëllime të:
  - 1.1. Zhvillimit të vazhdueshëm të procesit arsimor;
  - 1.2. Njohjes së studentëve me kërkimet shkencore dhe me punën artistike;
  - 1.3. Vazhdimin të zhvillimit shkencor - profesional dhe artistik të rinjve;
  - 1.4. Themelimit të rrjetit ndërkombëtar të studiuesve dhe artistëve;
  - 1.5. Përgatitjes dhe paraqitjes së projekteve studimore dhe artistike ndërdisiplinore konkurruese.
2. Kërkimet shkencore bëhen nga njësitë akademike të kolegjit në dy mënyra:
  - 2.1. Nga kërkimet themelore me qëllim të krijimit të dijeve të reja;
  - 2.2. Nga kërkimet e aplikuara që janë në lidhje të ngushtë me nevojat dhe interesin publik.
3. Kërkimet shkencore dhe krijimtaria artistike bëhen sipas këtyre kushteve themelore:
  - 3.1. Përmes fondeve publike të siguruara nga kolegji;
  - 3.2. Përmes fondeve private nga kontraktorët individualë me palën e tretë.
  - 3.3. Përmes konkurrimit në projekte vendore e ndërkombëtare.

**Neni 86**  
**Përgjegjësitë e kolegjit dhe personelit akademik**

1. Kolegji është i obliguar t'u ofrojë kushte të përshtatshme për kërkime shkencore dhe për krijimtari artistike dhe t'i mundësojë personelit akademik të arrijë rezultate konkurruese në nivel ndërkombëtar.
2. Personeli akademik i kolegjit është i obliguar të bëjë kërkime shkencore dhe punë krijuese në përputhje me aftësitë e tyre profesionale dhe obligimet që dalin nga udhëzimet strategjike të këshilli akademik si dhe të këshillave të njësive përkatëse akademike.
3. Vlerësimi individual i punës artistike dhe kërkimit shkencor do të merret parasysh në vlerësimin profesional dhe në ngritjen profesionale.

**Neni 87**  
**Zhvillimi i kërkimeve në lokacione të tjera**

1. Kërkimet shkencore dhe krijimtaria artistike bëhen brenda objekteve dhe hapësirave të kolegjit.
2. Me propozimin e këshillit të njësisë akademike, rektori mund t'i japë leje personelit akademik të kryejë kërkime dhe punë krijuese në lokacionet e caktuara jashtë kolegjit dhe të marrë pjesë në projektet e përbashkëta me institucionet tjera.

**Neni 88**  
**Viti i lirë për kërkime**

1. Profesorët e kolegjit kanë të drejtë të kërkojnë nga këshilli akademik që t'u lejohet një vit i lirë i kërkimeve të fokusuara (vit sabbatical) në një kolegji apo institut kërkimor të huaj.
2. Vendimi pozitiv i kërkimeve të fokusuara për një vit kërkon:
  - 2.1. Paraqitje për projektin kërkimor;
  - 2.2. Së paku pesë (5) vjet angazhim në mësimdhënie dhe kërkime;
  - 2.3. Kompetencë të dëshmuar shkencore dhe njohje brenda komunitetit shkencor ndërkombëtar;
  - 2.4. Ftesë për kërkime shkencore nga një institut apo kolegji i huaj.
3. Gjatë vitit të liruar, i punësuarit do të marrë pagën e plotë.
4. Pas vitit të kërkimeve të fokusuara, i punësuarit ka të drejtë të kthehet në pozitën e njëjtë të punës me kushte të njëjta si më parë.
5. I punësuarit ka të drejtë të shfrytëzimit të serishëm të vitit të lirë për kërkime të fokusuara me pagë të plotë pas një periudhe angazhimi në mësimdhënie dhe kërkime prej së paku pesë (5) vitesh.
6. Të punësuarit mund t'i lejohet kohë e lirë pa pagesë me propozim të këshillit të njësisë përkatëse akademike dhe vendim të rektorit.

**III. ZHVILLIMI DHE SIGURIMI I CILËSISË**

**Neni 89**  
**Sistemi i cilësisë dhe standardet**

1. Kolegji zhvillon sistemin e vet të sigurimit të cilësisë me qëllim të ruajtjes së cilësisë dhe të arritjes së objektivave të misionit dhe veprimtarisë së tij.
2. Sistemi i brendshëm i sigurimit dhe cilësisë është në pajtim me standardet vendore për sigurim të cilësisë dhe akreditim të programeve dhe akreditim institucional si dhe në harmoni me standardet dhe referencat në nivel evropian si standardet e ENQA-së (European Network of Quality Assurance).

**Neni 90**  
**Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë**

1. Si pjesë e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, kolegji organizon vlerësime të brendshme për gjithë spektrin e kolegjit dhe shërbimet e tij.
2. Vlerësimet analizojnë efikasitetin dhe efektshmërinë e funksionimit të kolegjit në të gjitha fushat e veprimit.
3. Sistemi i sigurimit të cilësisë u siguron njërive të vlerësuara dhe organeve përgjegjëse të qeverisjes treguesit për masat e sigurimit dhe përmirësimin e cilësisë, si dhe vendimet që kanë të bëjnë me personelin dhe organizimin.

**Neni 91**  
**Llojet e vlerësimeve**

1. Vlerësimet e parapara:
  - 1.1. Themelimin dhe përshtatjen e programeve të studimit;
  - 1.2. Reformimin e programeve të studimit;
  - 1.3. Masat organizative si themelimi, përshtatja dhe shkrirja e njërive institucionale;
  - 1.4. Arritja e qëllimeve sociale në nivel programi, njësie akademike apo institucionale;
  - 1.5. Vlerësimi i programeve të studimit dhe organizimit të studimeve;
  - 1.6. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies;
  - 1.7. Vlerësimi i aktiviteteve kërkimore;
  - 1.8. Vlerësimi i punës artistike;
  - 1.9. Vlerësimin e aktivitetit ndërkombëtar të njësisë apo kolegjit;
  - 1.10. Vlerësimi i shërbimeve administrative për studentë;
  - 1.11. Vlerësimi i praktikave menaxheriale në nivel fakulteti apo kolegji.

**Neni 92**  
**Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies**

1. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies nga ana e studentëve bëhet në përfundim të secilit semestër përmes pyetësorëve anonim.
2. Pyetësorët hartohen në detaje nga Komisioni për Sigurimin e Cilësisë në nivel Kolegji.

3. Vlerësimi i studentëve për cilësinë e mësimdhënies është pjesë përbërëse e sistemit të vlerësimit dhe menaxhimit të performancës së personelit akademik, që do të detajohet në një rregullore të veçantë.

#### **IV. PERSONELI AKADEMIK**

##### **Neni 93**

##### **Detyrat dhe roli i personelit akademik**

1. Personeli akademik ka lirinë e shprehjes. Anëtarët e personelit akademik kanë lirinë të pyesin dhe testojnë njohuritë e marra dhe të shprehin idetë e reja, mendimet kundërshtuese pa e vënë veten në rrezik me humbjen e punës apo çfarëdo statusi pune apo privilegji që mund të kenë në kolegji.

2. Personeli akademik ka lirinë për të publikuar rezultatet e punës së tyre kërkimore dhe krijuese, që kushtëzohet me rregulloret e këtij statuti që ka të bëjë me përdorimin e të drejtave të pronës intelektuale për dobi të kolegjit.

##### **Neni 94**

##### **Parimet udhëheqëse të personelit akademik**

1. Personeli akademik i kolegjit është i obliguar të respektojë:

1.1. Frymën e humanizmit;

1.2. Autonominë e kolegjit;

1.3. Lirinë e kreativitetit shkencor dhe artistik;

1.4. Aktet e kolegjit dhe vendimet e bazuara në to;

1.5. Parimet e ndershmërisë profesionale dhe shkencore;

1.6. Kodin e Etikës;

1.7. Reputacionin e kolegjit.

##### **Neni 95**

##### **Pjesëmarrja në punën e institucionit**

Personeli akademik duhet të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve dhe komisioneve ku janë të caktuar si anëtarë dhe t'i kryejnë detyrat e tilla me përkushtim dhe profesionalizëm.

##### **Neni 96**

##### **Llojet e kontratave**

1. Të gjitha vendet e punës do të bazohen në kontratat me normë të plotë dhe kontratat me gjysmënormë.

2. Përfundimisht, këshilli drejtues mund të përcaktojë mundësinë e kontratave me vëllim tjetër angazhimi.
3. Këshilli drejtues nxjerr rregullore të veçanta për kontratat kolektive për personelin akademik në përputhje me ligjet në fuqi.

#### **Neni 97**

#### **Efektet e marrëdhënies së rregullt të punës**

1. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë institucion tjetër.
2. Personeli në marrëdhënie të rregullt pune, i cili mund të jetë i angazhuar, zgjedhur apo emëruar në ndonjë institucion tjetër publik, nuk ka të drejtë për t'u zgjedhur në organe drejtuese, por ka të drejtë për të zgjedhur.

#### **Neni 98**

#### **Përgjegjësitë dhe përbërja e personelit akademik**

1. Personeli akademik ka përgjegjësitë, të cilat përcaktohen me kontratë dhe akte tjera përcjellëse për detyrat e personelit, si vijon:
  - 1.1. Mësimdhënie;
  - 1.2. Kërkime shkencore;
  - 1.3. Shërbime ndaj zhvillimit të institucionit si funksionet në komisione, grupe punuese, mentorim dhe menaxhim të projekteve;
  - 1.4. Shërbime për komunitetin përmes kolegjit.
2. Sistemi i vlerësimit dhe menaxhimit të performancës së personelit akademik dhe avancimit akademik duhet të reflektojë detyrat më lart.
3. Personeli akademik përbëhet nga:
  - 3.1. Profesorët e rregullt;
  - 3.2. Profesorët e asociuar;
  - 3.3. Profesorët asistentë;
  - 3.4. Ligjërues;
  - 3.5. Asistent;
  - 3.6. Profesorët vizitorë;
  - 3.7. Hulumtuesit dhe studiuesit vizitorë;
  - 3.8. Profesorët dhe asistentët e angazhuar (adjunct).

4. Shkurtesat zyrtare për personelin akademik janë:

4.1. Profesor i rregullt – Prof.;

4.2. Profesor i asociuar – Prof. asoc.;

4.3. Profesor asistent – Prof. asst.;

4.4. Ligjërues;

4.5. Asistent kolegji – Asst.;

4.6. Hulumtues.

5. Në pajtim me dispozitat e këtij statuti, këshilli akademik nxjerr rregullore përcjellëse për procesin e avancimit akademik dhe rizgjedhjes.

#### **Neni 99**

##### **Emërimi i personelit akademik**

1. Personeli akademik emërohet nga rektori sipas vendimit të këshillit akademik.
2. Procedurat për emërim do të bëhen në mënyrë transparente.
3. Te gjitha emërimet bëhen pasi komisioni vlerësues, i formuar nga këshilli akademik, të shqyrtojë dokumentacionin e aplikimit. Komisioni vlerësues e bën vlerësimin e kandidatëve, të cilët konsiderohen që kanë përmbushur kushtet për postin e ofruar.
4. Komisioni vlerësues i raporton këshillit që e ka formuar në afat të caktuar.
5. Askush nuk mund të jetë anëtar i komisionit vlerësues nëse është bashkëshort, partner ose anëtar i familjes së ngushtë të kandidatit që duhet të emërohet.

#### **Neni 100**

##### **Programi për profesorët e diasporës (kthimi i trurit)**

1. Personeli akademik i diasporës që është në marrëdhënie të rregullt pune në një kolegji në Evropë ka të drejtë transferimi në kolegji pa ju nënshtruar procedurave të konkursit publik.
2. Rektori pasi të ketë marrë lejen e këshillit drejtues (për pjesën e buxhetit) mund të shpallë një konkurs për profesor apo hulumtues nga diaspora me kushte të veçanta të angazhimit të cilat do të rregullohen me një rregullore të këshillit akademik.

#### **Neni 101**

##### **Kushtet e përgjithshme për emërim dhe avancim**

1. Titujt akademik jepen në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë.

2. Kushtet për emërimin dhe avancimin në çfarëdo titull të personelit akademik janë të rregulluara me rregulloren për promovim akademik të IBC-M.

#### **Neni 102**

##### **Parimet e procesit të emërimit dhe avancimit**

1. Emërimi dhe avancimi i personelit akademik do të bëhet në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe të mbështetur në meritë dhe transparencë. Procedura e emërimit dhe avancimit të personelit akademik do të mbështetet në parimin e ndalimit të konfliktit të interesit, ndalimit të papajtueshmërisë me funksionin dhe në respekt të integritetit në vendimmarrje akademike dhe të arsyetuar.
2. Titujt akademik të marrë më herët në IBCM, automatikisht do të bartën në kolegjin publik IBC-M.
3. Kolegji ruan të drejtën e njohjes së titujve akademik të marrë në institucione tjera të licencuara dhe akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, e që nuk bijën në kundërshtim me kriteret e rregullores të IBC-M.

#### **Neni 103**

##### **Heqja e titullit**

1. Këshilli akademik, me arsye dhe me argumente të forta dhe me rekomandim të Këshillit të Etikës, mund t'ia heqë titullin bartësit.
2. Arsyeja dhe argumenti i fortë përmban:
  - 2.1. Falsifikimin apo mashtrimin gjatë vlerësimit ose provimit;
  - 2.2. Plagjiaturën apo shkeljen e të drejtës së autorit në përgatitjen e diplomës apo të punimit tjetër me shkrim;
  - 2.3. Praktikë tjetër joetike.
3. Mospërmbushja e kriterëve të rizgjedhjes apo mirëmbajtjes së titullit nënkupton kthim në titullin paraprak.

#### **Neni 104**

##### **Kodi dhe Këshilli i Etikës**

1. Këshilli drejtues, me propozimin e këshilli akademik nxjerr rregulloren e kodit etik të kolegjit. Kodi etik përmban rregulla të qarta për ndalimin e sjelljeve të pahijshme dhe të palejuara për personelin akademik, studentët dhe anëtarët tjerë të personelit, dhe sanksionet që u vendosen subjekteve që konsumojnë shkelje të tilla.
2. Fushëveprimi i kodit etik do të respektojë parimin e integritetit personal, integritetit akademik, të drejtat e autorit, ndershmërinë në hulumtime shkencore, transparencën dhe mbrojtjen e të drejtave të tjetrit.
3. Kodi etik përcakton gjithashtu strukturën dhe kompetencat specifike të Këshillit të Etikës, i cili është një organ që i gjykon pretendimet për shkeljet etike.



4. Këshilli i Etikës përbëhet nga anëtarë të shquar të kolegjit.

5. Kodi etik do të parashikojë sanksionet për shkeljet etike, ndër to edhe mundësinë e heqjes së titujve dhe lirimin nga detyra të personelit akademik dhe largimin e studentëve të sanksionuar. Lista e sanksioneve të parashikuara në kodin etik duhet të jetë e qartë, proporcionale me qëllimin që do të arrijë, e zbatueshme dhe e tillë që të arrijë qëllimin e adresimit të duhur të përgjegjësisë së të adresuarit. Në një rast të tillë, vendimi i këshillit duhet të konfirmohet nga këshilli akademik në mënyrë që të ketë efekt juridik.

#### **Neni 105**

#### **Rregullat për përgjegjësinë disiplinore, heqjen e titujve, pezullimin dhe ndërprerjen e marrëdhënies së punës**

1. Përgjegjësitë disiplinore të të punësuarve në kolegji dhe masat që duhet të ndërmerren përcaktohen me rregulloret e nxjerra nga këshilli drejtues.
2. Procedurat dhe kushtet për heqjen e titujve, pezullimin apo ndërprerjen e marrëdhënies të punës të stafit përcaktohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga këshilli drejtues pasi të jetë konsultuar me këshilli akademik.

#### **Neni 106**

#### **Titujt e nderit, çmimet dhe mirënjohjet e kolegjit**

1. Kolegji ua ndanë titujt e nderit personave të merituar.
2. Këshilli akademik do të nxjerrë rregullore të veçanta për procesin dhe procedurën e vendimmarrjes në përzgjedhjen e fituesve të titujve të nderit, çmimet për student të dalluar dhe mirënjohjet.

#### **Neni 107**

#### **Titulli “Doktor Nderi” (*Doctor Honoris Causa*)**

1. Titulli “Doktor Nderi” (“*Doctor Honoris Causa*”) jepet për:
  - 1.1. Arritje të mëdha në fushën e shkencës dhe artit;
  - 1.2. Kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e marrëdhënies njerëzore në mbështetjen dhe konsolidimin e paqes;
  - 1.3. Kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e kolegjit, shkencës, artit dhe kulturës.

#### **Neni 108**

#### **Titulli “Anëtar Nderi i Kolegjit”**

1. Titulli “Anëtar Nderi i Kolegjit” jepet për:
  - 1.1. Përkrahje të pandërprerë për kolegjin;
  - 1.2. Kontribut domethënës buxhetor apo financiar në zhvillimin e kolegjit.

## **V. KËSHILLI STUDENTOR**

### **Neni 109**

#### **Të drejtat e organizimit dhe bashkimit të studentëve**

1. Studentët kanë të drejtë të formojnë asociacione profesionale apo shoqata për çfarëdo qëllimi në pajtim me rregullativën në fuqi.
2. Studentët kanë të drejtë për tubime paqësore.
3. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore, të cilave mund t'u përkasin të gjithë studentët.
4. Secila organizatë studentore ka statutin e vet që miratohet nga anëtarët e saj në pajtim me rregulloret e përgjithshme të nxjerra nga këshilli drejtues. Statuti do të përfshijë parimet për mundësi të barabarta dhe mosdiskriminim.

### **Neni 110**

#### **Format e përfaqësimit të interesave të studentëve**

1. Formalisht, interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të kolegjit përmes:
  - 1.1. Këshillit të studentëve.
2. Anëtarët e këshillit të studentëve do të zgjidhen në pajtim me procedurat në fuqi për zgjedhjet.
3. Detajet për procedurën zgjedhore do të përcaktohen me rregullore të posaçme të nxjerra nga këshilli drejtues në konsultim me këshillin të studentëve.

### **Neni 111**

#### **Buxheti për Këshillin të Studentëve**

Këshilli drejtues ndan një buxhet të përshtatshëm vjetor për veprimtarinë e këshillit të studentëve me propozim të arsyetuar të këshillit të studentëve.

### **Neni 112**

#### **Këshilli i Studentëve**

1. Këshilli i Studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve.
2. Numri i tërësishëm i anëtarëve të këshillit të studentëve është 7.
3. Kryetari i këshillit të studentëve zgjidhet me votën e shumicës së anëtarëve të këshillit përfaqësues të studentëve.
4. Këshilli drejtues nxjerr rregulloren e punës për këshillin e studentëve.

## **VI. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

### **Neni 113**

1. Kolegji zhvillon bashkëpunim ndërkombëtar, i cili përfshin: organizimi e studimeve të dyfishta dhe të përbashkëta, pjesëmarrjen në projekte, bashkëpunimin me kolegjet, akademitë kombëtare dhe të tjera, komunitetin e biznesit, institutet dhe qendrat publike e private dhe lëndë të tjera me qëllim të avancimit të veprimtarisë së arsimit të lartë, shkencor e profesional.
2. Kontrata për programe të dyfishta apo të përbashkëta nënshkruhen nga rektori dhe koordinohen nga zyra për marrëdhënie ndërkombëtare dhe dekanët e programeve përkatëse të studimeve.
3. Kolegji mund të nënshkruaj dy apo më shumë marrëveshje bashkëpunimi për programe të dyfishta me universitete të ndryshme dhe regjistrimi i studentëve dhe përzgjedhja e programeve mund të jetë opcionale.
4. Kolegji mund të angazhoj staf akademik nga diaspora për periudhe të shkurt kohore nga një javë deri në 9 muaj për pozita si profesorë vizitore, hulumtues, post-doktorate dhe projekte shkencore.

## **VII. PLANIFIKIMI, MENAXHIMI FINANCIAR DHE RAPORTIMI**

### **Neni 114**

#### **Procesi i menaxhimit financiar në kolegji dhe njësi akademike**

Ministria e Financave siguron financimin e duhur për kolegjin për të përmbushur obligimet dhe përgjegjësitë e saj që dalin nga dispozitat e këtij statuti.

### **Neni 115**

#### **Burimet e të hyrave buxhetore**

1. Kolegji, në përputhje me dispozitat e këtij statuti, ka të drejtë të pranojë fonde nga këto burime:
  - 1.1. Alokimet nga Ministria e Financave, për mësim, kërkime shkencore dhe punë artistike me interes të përgjithshëm në bazë të buxhetit të miratuar;
  - 1.2. Tarifat për shkollim dhe pagesat tjera të paguara nga studentët;
  - 1.3. Pagesat për shërbime komerciale dhe shërbimet tjera;
  - 1.4. Donacionet, dhuratat dhe ndihmat;
  - 1.5. Kontratat me organet vendore, ndërkombëtare, publike dhe private, për mësimdhënie, kërkime shkencore, punë artistike dhe këshillime apo ekspertiza.

**Neni 116**  
**Lidhja e kontratave dhe investimi i fondeve**

1. Kolegji është i lirë që të lidhë kontratë për çfarëdo qëllimi që ka të bëjë me arsimin e lartë, me kërkimet shkencore apo punën artistike. Kolegji mund të investojë fonde, përveç atyre publike, në çdo ndërmarrje që ka qëllime arsimore, kërkimore - shkencore apo qëllime artistike nëse:

1.1. Kontratat që imponojnë detyrime ndaj pronës së aseteve publike janë në përputhje me ligjin në fuqi dhe kanë pëlqimin e ministrisë që mbulon arsimin dhe ministrisë përgjegjëse për financa;

1.2. Nuk vihen në rrezik fondet publike.

**Neni 117**  
**E drejta për shfrytëzim të tokës, ndërtesave, aseteve dhe pajisjeve**

Nga institucionet e Republikës së Kosovës (më tej institucionet publike), po që se plotësohen kushtet e përcaktuara me Ligjin për Arsimin e Lartë të Kosovës, kolegjit i jepet e drejta për shfrytëzimin e tokës shoqërore dhe publike, ndërtesave, aseteve publike dhe pajisjeve për t'i shërbyer interesit publik.

**Neni 118**  
**Raporti vjetor i buxhetit**

1. Buxheti i shpenzuar do të raportohet më së voni deri më 31 janar të vitit tjetër në vijim.
2. Raportet buxhetore do të përgatiten në bazë të standardeve të përcaktuara nga Ministria e Financave - Thesari.
3. Departamenti i Buxhetit dhe Financave i Kolegjit do të përgatisë raportin vjetor për shpenzimin e buxhetit në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

**Neni 119**  
**Pagesat e studentëve**

1. Pagesat e studentëve bëhen për shërbime specifike të ofruara nga kolegji në kohën e programit të studimeve.
2. Pagesat vjetore të studentëve janë gjithëpërfshirëse në pajtim me rregulloret e veçanta të ministrisë dhe përbëjnë të gjitha shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës së rregullt të studimeve, në përputhje me dispozitat e këtij statuti.
3. Pagesat e studentëve vlejné për studimet themelore – bachelor, studimet master dhe studimet e doktoratës.
4. Këshilli drejtues nxjerr rregullore të detajuar për llojin dhe shumën e pagesës së studentëve që do të jetë në pajtim me rregulloret përkatëse të nxjerra nga ministria.

## **Neni 120** **Raporti vjetor**

1. Autoriteti menaxhues, të cilit i është dhënë autorizimi, ka për detyrë t'ia dorëzojë rektorit raportin vjetor të detajuar në lidhje me të gjitha aspektet e udhëheqjes relevante, përfshirë:
  - 1.1. Kontratat dhe marrëveshjet;
  - 1.2. Shfrytëzimin e përgjithshëm të burimeve;
  - 1.3. Llogarinë dhe rrjedhën e buxhetit;
  - 1.4. Punësimin e personelit të veçantë;
  - 1.5. Shfrytëzimin e pajisjeve dhe godinave;
  - 1.6. Përbushjen e objektivave të projektit.
2. Autoriteti menaxhues është përgjegjës që të dorëzojë raportin e tillë edhe për periudhën më të shkurtër, me kërkesë të rektorit.
3. Në rast të keqpërdorimit të autorizimit, rektori ka të drejtë të pezullojë autorizimin derisa të marrë një vendim përfundimtar këshilli drejtues i kolegjit.

## **Neni 121** **Bordi industrial dhe këshillëdhënës**

1. Bordi industrial dhe këshillëdhënës themelohet nga Këshilli Akademik i IBC-M me propozim të Rektorit.
2. Karakteri i Bordit Industrial dhe këshillëdhënës (në tekstin e mëtejme Bordi) është strukturë këshillëdhënëse pa kompetencë ekzekutive dhe bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve, si dhe në përkushtimin e IBC-M për ngritjen e cilësisë së arsimit të lartë në fushën e veprimtarisë së tij.
3. Bordi përbëhet nga përfaqësues të ndërmarrjeve dhe institucioneve, me të cilat IBC-M ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi profesionale.
4. Pas konstituimit të Bordit dhe zgjedhjes së Kryetarit, Bordit mund t'i bashkohen edhe anëtarë të tjerë, të cilët nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi me IBC-M.

## **Neni 122** **Anëtarët e Bordit**

1. Anëtarët e Bordit janë përfaqësues të tregut të punës, të cilët janë vendimmarrës në kompani private apo publike, si dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare e joqeveritare, relevante për fushë-veprimtarinë e IBC-M.

2. Anëtarë ex-officio të Bordit janë Rektori (me të drejtë vote), Prorektorët dhe Dekanët e njësive akademike (pa të drejtë vote), si dhe një përfaqësues nga administrata e IBC-M (pa të drejtë vote).
3. Rektori përgatit mbledhjen konstituive të Bordit, përpilon materialet si i përket rendit të ditës dhe ndërmerr aktivitete të tjera për mbarëvajtjen e punës së Bordit.

### **Neni 123 Organet e Bordit**

1. Bordi e zgjedh Kryetarin nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës, me të cilët IBC-M ka marrëveshje bashkëpunimi. Kryetari i Bordit udhëheq mbledhjet dhe kujdeset që informatat rreth mbledhjeve të shpërndahen te të gjithë anëtarët e tij, si dhe palëve të tjera të interesit.
2. Bordi zgjedh edhe nënkryetarët nga radhët e industrive përkatëse (tre (3) nënkryetarë, të cilët duhet të jenë nga fushat e studimeve të fakulteteve përkatëse).
3. Këta nënkryetarë, bashkë me Kryetarin e Bordit, udhëheqin mbledhjet me anëtarët e industrive përkatëse.
4. Funkionimi dhe fushëveprimi i Bordit rregullohet, me rregullore të veçantë, të nxjerrë nga Këshilli Akademik/Senati i IBC-M-së.

## **VIII. DISPOZITAT KALIMTARE, PËRFUNDIMTARE DHE SHFUQIZUESE**

### **Neni 124 Dispozitat kalimtare**

1. Statuti i përkohshëm propozohet nga këshilli themelues i IBC-M.
2. Të gjitha vendimet, rregulloret dhe aktet tjera të nxjerra nga Bordi Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i IBC-M, vazhdojnë të zbatohen, deri në nxjerrjen e akteve të harmonizuara me dispozitat e këtij Statuti.
3. Brenda maksimumi një (1) viti nga hyrja në fuqi e këtij Statuti, do të bëhen zgjedhjet e përgjithshme të IBC-M në pajtim me dispozitat e këtij Statuti.
4. Asetet e (1) “International Business College Mitrovica”, themeluar nga Fondacioni ndërkombëtar Spark në vitin 2010; si dhe të (2) “International Business College Mitrovica (IBC-M)” themeluar si fondacion vendor në vitin 2018; do të barten si donacion tek Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë (IBCM).
5. Pasi dhurimit të aseteve në formë të donacionit nga fondacionin IBC-M tek Kolegji Publik Ndërkombëtar i Biznesit në Mitrovicë (IBCM), fondacioni do të shndërrohet në Institut për Kërkime dhe inovacion i cili do të jetë pjesë përbërëse e Kolegjit Publik Ndërkombëtar të Biznesit (IBCM).

## **Neni 125**

### **Programet e studimeve ne fuqi si dhe bartja e thirrjeve akademike ne IBC-M**

1. Të gjitha programet e studimeve, që janë duke u zbatuar në kohën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti konsiderohen të aprovuara në pajtim me vendimet mbi akreditimin e tyre të nxjerra nga Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) dhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-MASHTI.
2. Të gjitha thirrjet akademike të marra më herët në kuadër të fondacionit IBCM si institucion i arsimit të lartë do të barten në kolegjin publik IBC-M.

## **Neni 126**

### **Kontratat e personelit**

1. Të gjitha kontratat e personelit akademik të rregullt dhe me gjysmë normë do të vazhdojnë me të njëjtat kushte deri me datën e caktuar në kontratë. Vazhdimi i kontratave bëhet në pajtim me këtë Statut.
2. Të gjitha aktet e emërimit dhe kontratat e personelit joakademik vazhdojnë me të njëjtat kushte në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 127**

### **Dispozitat përfundimtare**

1. Kolegji IBCM do t'i harmonizojnë aktet dhe rregulloret ekzistuese në përputhje me këtë Statut, pasi që ky Statut të hyjë në fuqi.
2. Deri në nxjerrjen e akteve sikurse në pikën një të këtij neni, do të aplikohen rregulloret dhe aktet tjera në fuqi përveç në rastet kur ato janë në kundërshtim me këtë Statut dhe Ligjin për Arsimin e Lartë.

## **Neni 128**

### **Dispozita shfuqizuese**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij statuti pushojnë së vlejuri dispozitat e Statutit të fondacionit IBC-M (si institucion i arsimit të lartë), të gjitha rregulloret dhe vendimet që janë në kundërshtim me këtë Statut.
2. Në rast të ndonjë paqartësie në këtë Statut, më kërkesën e Këshillit Themelues, MASHTI jep sqarim përmes të një akti nënligjor.

**Neni 129**  
**Miratimi**


Statuti i propozohet Ministres së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për miratim.

**Neni 130**  
**Hyrja në fuqi**

Statuti hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Ministri i Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

Miratuar më 12.12.2023

Arbërie Nagavci

  
Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit